


Bashkia Klos



Raporti Performancës 2021



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2021 të Bashkisë Klos.

[Klos - Raporti i Performances 2021 | Tableau Public](#)

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Klos me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021	4
Burimet e Financimit	5
Shpenzimet buxhetore	6
Investimet	7
Administrimi i bashkisë	8
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara.....	10
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	12
Furnizimi me ujë	14
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	16
Rrjeti rrugor rural	18
Strehimi Social	21

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përsëmbull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021

Bashkia Klos

Bashkia Klos arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë kanë pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse me ndikimin më të thellë ekonomik duke u krahasuar me vitin 2020 kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e bar-restoranteve e rimorën disi veten. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim e shërbime e për rrjedhojë rënien e fitimit të cilat çuan në rënien e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore që mbledh bashkia. Efekti i rënies së punës së bizneseve nuk është ndjerë në totalin e të ardhurave të veta të grumbulluara nga bashkia bashkisë të cilat janë rritur me rreth 10% kundrejt vitit të kaluar (2020) për shkak të mirëmenaxhimit nga ana e saj. Bizneset në një masë të konsiderueshme rifilluan punën të cilën e kishin ngaluar tërësisht ose përkohësisht përgjatë vitit 2020 për t'iu adaptuar kushteve të reja pandemike.

Një buxhet në rritje i bashkisë vjen për shkak të mbështetjes nga qeveria qendrore e cila ka rritur me rreth 6% kontributin e saj kundrejt vitit 2020 një kontribut cdo vit në rritje ky, kryesisht për shkak të projekteve të financuara nga ministritë e linjës ose institucione të tjera qendrore.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:

- ✿ Dyfishimi i peshës së investimeve dhe rënia peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✿ Mbështetje me shërbime sociale duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë
- ✿ Ruajtjen e numrit të personelit të bashkisë dhe gjithë institucioneve të bashkisë
- ✿ Rritja e peshës së të ardhurave të veta kundrejt një viti më parë, por ende përfaqësojnë një kontribut fare modest në gjithë burimet e financimit të buxhetit të bashkisë.

Ekzekutimi i buxhetit nuk ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, për shkak të shumë projekteve me financim të qeverisë qendrore, të cilat do të vazhdojnë të zbatohen përgjatë vitit 2022.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë Lekë)		FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
		557,920	640,610	706,489	505,663	140%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2020 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat lokale	19,850	5,586	6,035	8,890	67.9%
	Të ardhurat e tjera	5,864	6,719	11,431	21,107	54.2%
	Huamarrje	0	0	0	0	0
	Të ardhura nga taksat e ndara	4,134	9,942	9,102	5,260	173.0%
	Të ardhura nga tarifa vendore	13,071	15,352	15,337	18,240	84.1%
	Transferta e kushtëzuar	280,830	372,714	396,251	173,574	228.3%
	Transferta e pakushtëzuar	134,094	137,653	140,406	140,406	100.0%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trasferta specifike	62,779	63,377	72,109	67,205	107.3%
	Trashëgimi nga viti i shkuar	37,297	29,266	55,818	70,982	78.6%





Figura 1. Peshat e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia mbështetet në 86% të buxhetit të saj nga nga transfertat e qeverisë qendrore, ku të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë fare modeste. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 10% kundrejt vitit 2020 dhe u realizuan në masën 140% të planit të vitit 2021;
- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë u rritën në total me 11% kundrejt një viti më parë si rrjedhojë e mirëmenaxhimit të të ardhurave vendore nga administrata fiskale e bashkisë
- ✿ Peshat e të ardhurave nga burimet e veta ka mbetur e njëjtë me një vit më parë.

Shpenzimet buxhetore

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT (Në mijë Lekë)	FAKT2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 NË %
	513,638	555,945	644,719	727,454	89%




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rritje kundrejt vitit 2020 me rreth 16%, duke reflektuar kështu rritjen e burimeve të financimit kryesisht nga të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifatat vendore, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 89%, ose një mosrealizim prej 11% i planit të bashkisë si rrjedhojë e mosrealizimit të disa projekteve të investimeve. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ Administrimi
- ✿ Rrjeti rrugor
- ✿ Kujdesi social për PAK
- ✿ Furnizimi me ujë
- ✿ Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
- ✿ Strehimi social
- ✿ Arsimi bazë përfshirë parashkollorin

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë Lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	192,029	112,961	106,501	144,895	74%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 107 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet kanë rënë me rreth 6%, për rrjedhojë edhe kontributi i tyre në buxhet është zvogëluar. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 74%, ose një mos realizim në masën 26% të planit fillestar për shkak të mosrealizimit të investimeve në projekte të trashëgimisë kulturore.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2021 tregojnë se:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2021 rreth 17% të buxhetit të bashkisë një peshë e modeste në totalin e shpenzimeve të bashkisë
- ✿ Fokusi i investimeve janë shërbimet e infrastrukturës rrugore, furnizimi me ujë të pijshëm, menaxhimi i rrjetit vaditës dhe kullues etj.

Administrimi i bashkisë




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korrente dhe investim

Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numer kundrejt vitit të kaluar)	0	-5	1	0
Numri i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	8.40	2.45	4.90	6.94
Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	1.75	2.17	0.80	3.57

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total	35	50	12	50
Numri total i personave të trajnuar	20	23	15	14

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri total i punonjësve të bashkisë	238	245	245	245
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	72	72	72	72
Numri total i punonjësve ne njesite shpenzuese	166	173	173	173
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	20	6	12	17
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	10	5	6	5
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë Në mijë lekë			48,871	
Shpenzime për investime Në mijë lekë	4,576	265	5,298	6,157
Shpenzime korente Në mijë lekë	73,012	72,442	22,378	87,208

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 82% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 13% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2021 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Janë marrë më shumë masa disiplinore për punonjësit e bashkisë, si rrjedhojë e rritjes së monitorimit të punës së punonjësve e për rrjedhojë kjo ka sjellë rënie në vlerat e treguesit të performancës së punës së tyre
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë. Gjithësesi numri mesatar i ditëve të trajnimit për një person të trajnuar është më i ulët sesa një vit më parë
- ✿ Është rritur numri i personave që kanë lëvizur nga puna si rrjedhojë e masave disiplinore të marra për shkak të cilësisë së punës, duke ulur qëndrueshmërinë e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Administrimi i bashkisë	4,576	265	5,298	6,157	86%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Blerje kasaforta për njësitë administrative dhe ujësjellësin			0	144	0%
Blerje Kompjuter per Keshillin		98			

Blerje license (SPSL)per regjistrim elek.kerkesash		86			
Blerje pajisje kompjuterike per zyren e Urbanistikes			467	500	93%
Blerje pajisje kompjuterike për administratën			899	960	94%
Blerje pajisje kompjuterike per MZSH		78			
Blerje pajisje për shërbimin social (UNDP)			3,736	490	762%
Blerje Printer per Administraten		55			
Hartim projekt ide Gurra e Gurit të Bardhë		96			
Kontr. Rikonstruksion zyra e keshillit	2,094	0	0	535	0%
Mbikq.rikonst.zyra e Keshillit		24			
Pajisje zyre për administratën			491	500	98%
Rik.ambj.brendsh.,dhe jash. te kopsht.klos		942			
Vendosja e shenjave për ecje ne shtigje dhe male			0	987	0%
Video projektor per dhunen ne familje			89	90	99%

Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Rritja ose përmirësimi i skema / institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
	Numri shërbimeve të ofruara për persona PAK në shtëpi (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0
	Perfitimi monetar (në mijë lekë) për persona të sëmurë dhe PAK	117.3	130.0	133.1	78.6
	Persona me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0
	Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti (Ndryshimi vjetor në numer)	150	-8	-100	101
	Shpenzimet totale në qendrat e shërbimeve PAK kundrejt numrit total të personave të akomoduar në këto qendra (Mijë Lekë/Person)				

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti	932	924	824	925
Numri i personave të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale	0	0	0	0
Numri i personave me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale për personat PAK			824	
Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzime totale për qendrat rezidenciale PAK Në mijë lekë				
Shpenzimet totale për mbështetjen e personave PAK Në mijë lekë	109,335	120,132	109,694	72,696

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 99% kundrejt planit 2021. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 24% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara:

- ✿ Mbështetur persona të sëmurë me pagesë invaliditeti
- ✿ Më shumë para mesatarisht në vit për person të mbështetur
- ✿ Është ruajtur numri i shërbimeve për personat që u bëhet shërbimi në shtëpi.

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Trendi

Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Familjeve ne nevoje te mbeshtetura (Ndryshimi vjetor në numer)	2	0	0	2
Fëmijë pa përkujdes prindëror që kanë perfituar nga shërbimet e shërbimit social (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0
Fëmijë që kanë përfituar nga shërbimi në qendra sociale dhe rezidenciale (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0
Gra viktime të dhunës në familjet të trajtuara me mbështetje (Ndryshimi vjetor në numer)	1	-1	-3	2
Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale (Ndryshimi vjetor në numër)	0	0	0	0
Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0
Shpenzimet per ushqim kundrejt totalit te numrit te personave te shërbyer ne qendrat sociale (rezidenciale; ditore). Mijë Lekë ushqim				

për person te shërbyer në qendrat sociale dhe rezidenciale

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të shërbyer në Qendra ditore	0	0	0	0
Fëmijë të shërbyer në Qendra rezidenciale	0	0	0	0
Familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetura nga bashkia	6	6	6	8
Fëmijë pa kujdes prindëror që kanë marrë kujdes nga bashkia	0	0	0	0
Viktima të dhunës në familje dhe / ose viktima të trafikuar të mbështetura nga bashkia	9	8	5	10
Fëmijë të shërbyer në kopshte dhe çerdhe				
Fëmijë në kopshte				
Fëmijë në çerdhe				
Kopshte dhe çerdheve funksionale				
Kopshte				
Çerdhe				
Numri personave të mbështetur me ndihmë ekonomike			1,449	

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për familjet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 98% kundrejt planit 2021. Alokimi i fondeve të shtuara për familjet dhe fëmijët lidhet me shërbimet që ka ofruar bashkia për ti ardhur në ndihmë familjeve në nevojë përgjatë emergjencave të pandemisë.

Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 24% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë si :

- ✿ Familje dhe fëmijë në nevojë
- ✿ Fëmijë pa kujdes prindëror
- ✿ Fëmijë në qendra ditore
- ✿ Gra dhe fëmijë viktima të dhunës
- ✿ Fëmijët e shërbyer në kopshte

Furnizimi me ujë




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investim

Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Orë ujë në ditë (Ndryshimi ditor në orë)	0.0	1.0	3.0	-2.0
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	20.0	30.0	38.4	40.0
Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (përfshirë investime dhe amortizimi) (në %)				
Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzime korente (në %)	0.0	0.0	377.5	0.0

Produkte

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (mesatarisht orë në ditë dhe natë)	4	5	8	6
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	4,117	6,175	8,000	8,157

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) Në mijë lekë				
Popullsia totale e bashkisë	20,583	20,583	20,821	20,393
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm Në mijë lekë			9,436,700	
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm Në mijë lekë	21,626	50,631	2,500,000	19,898

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në masën 180% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 11% të buxhetit të saj për ofrimin e ujit të pijshëm për komunitetin. Fondet e alokuara për këtë shërbim janë financim i qeverisë qendrore për projektin e ujësjellësit. Aktualisht uji i pijshëm ofrohet nga UK Klos, e cila synon të mbulojë koston e ofrimit të shërbimit me anë të tarifave të grumbulluara nga familjet, bizneset dhe institucionet publike. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Rritjen e nivelit të mbulimit me ujë të pijshëm të familjeve dhe bizneseve dhe vazhdimin e punës për të futur në skemën e furnizimit me këtë shërbim edhe të familjeve që nuk e aksesojnë deri më sot
- ✿ Më shumë territor është mbuluar me furnizimin e ujit të pijshëm
- ✿ Ulja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët
- ✿ Mbulimi i koston së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifat e shërbimit.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Furnizimi me ujë	21,626	37,740	52,380	58,146	90%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Furnizim-Vendosje sistem hidratimi			0	300	0%
Mbikq.Rikonstuksion ujesjellesi		800	739	300	246%
Rikonstuksion ujesjellesi		35,000	50,000	20,000	250%
Shërbim Proj.Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Dom - Shulbatër			0	500	

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor




Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor:

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	67	67	98	69
Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	9		8	8
Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	14		12	14
Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	1,379	1,480	1,634	1,806

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	27	26	23	29
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	119	117	109	117

Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	22	23	23	23
--	----	----	----	----

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	408	410	390	420
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	605	612	400	610
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	45	60	40	45
Mësues në sistemin parashkollor	29	31	31	33
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	189	192	162	192
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	1,619	0	1,335	1,630
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë Në mijë lekë	30,346	34,029	37,590	41,533

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 38% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë viteve të kaluara bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 3% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✿ Është rritur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Është ulur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues;
- ✿ Është rritur financimi i institucioneve arsimore.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	1,923	942	143	516	28%
Në mijë Leke					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje kompjuter dhe fotokopje per kopshtin Klos			143	153	93%
Kolaud.për rik.palestre shk.9-vjeçare Tahir Hoxha		0	0	55	0%
Mbikq.pë rik.palestre shk.9-vjeçare Tahir Hoxha		0	0	461	0%

Mbikq.Rik.ambj.brendsh.,dhe jash. te kopsht.klos		0		8	0%
Rikonstuksion shkolla e mesme	27,631	51,923			

Rrjeti rrugor rural




Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Raporti i rrugeve te asfaltuara ndaj totalit te rrugeve (te asfaltuara, cakull etj) ne %	0.0	0.0	11.8	0.0
Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)	3.0	2.0	307.8	0
Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në km linear)	3.0	2.0	292.0	0
Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në km linear)	0.0	0.0	15.8	0

➔	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0.0	0.0	60.0	-60.0
➔	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0.0	0.0	380.0	-380.0
➔	Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0.0	0.0	17.8	-17.8
⬆	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	348.7	217.2	125.5	325.0
➔	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mije Lekë për 1 km rrugë urbane	0.0	0.0	0.0	0.0
➔	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mije Lekë për 1 km rrugë rurale	0.0	0.0	0.0	0.0

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 98% të planit 2021, në një shumë prej 64 milionë lekë, nga të cilat një e treta e tyre kanë shkuar për investime. Bashkia shpenzon rreth 10% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Gjatë vitit 2021 ky shërbim i ofrua nga bashkia për rrjetin rrugor tregon se:

- ✿ Janë ulur aksidentet rrugore;
- ✿ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë.
- ✿ Është përgjysmuar kosto mesatare e 1 km linear rrugë të mirëmbajtur. Ndoshta kjo vjen prej një inventari më të mirë të rrjetit rrugor dhe jo prej ndryshimit të koston së shërbimit.
- ✿ Gjatësia e rrjetit rrugor është rritur falë projekteve të qeverisë qendrore.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	0.0	0.0	60.0	0.0
Rrugë rurale të mirëmbajtura	0.0	0.0	380.0	0.0
Rrugë urbane të mirëmbajtura	0.0	0.0	17.8	0.0
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	0.0	0.0	60.0	0.0
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	0.0	0.0	60.0	0.0
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	0.0	0.0	0.0	0.0

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	198	200	508	200
Rrjeti rrugor urban Në km linear	196	198	490	197
Rrjeti rrugor rural Në km linear	2	2	18	3
Numri aksidenteve rrugore (këmbësorë + automjete)	0	0	0	0

Numri i aksidenteve të automjeteve	0	0	0	0
Numri i aksidenteve të këmbësorëve	0	0	0	0
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë	69,048	43,431	63,738	64,841

INVESTIMET E BASHKISË	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Rrjeti rrugor rural	66,517	11,610	24,247	25,238	96%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje fadrome			3,600	3,600	100%
Blerje mat.per rik.rruges+banesa per te varfer		0	2,632		
Furnizim-Vendosje riparim kapital motorri+diferencial fadrome			399	400	100%
Hapje aksesesh,ndertim bokse urash ne fshatrat e Bashkise Klos		0			
Hapje aksi rruga Mali I Lezit Gurre		887			
Kol. Hapje rrug. nd. Boksesh ura ne fsh. Bashk. Klos		0	0	12	0%
Kol.rik.rr. Nj.Ad.G.+Hap. rr.Mali Lezit+Nd.ura Liçi		0	0	6	0%
Kolaud.Ndertim kamba ure ne Fshatin Xiber Murrize		0	11	11	100%
Kolaud.Ndertim mure mbajtes		0	8	9	89%
Kolaudim rik.pjesshem urban qytetit klos		0	0	25	0%
Kolaudim sistemim asfaltim i lagjeve te qytetit klos		0	0	15	0%
Kontr. Rikualifikim urban i Qytetit	5,333	0	9,700	10,143	96%
Kontr. Sistemim asfaltim ne lagjet e qytetit Klos	2,000	0	489	7,973	6%
Mbik. Hapje rrug.nd. Boksesh,ura ne fsh.bash. Klos		0	113	113	100%
Mbik.rik.rr. Nj.Ad.G.+Hap.rr.Mali Lezit+Nd.ura Liçi		0	56	56	100%
Mbikq.Ndertim kamba ure ne Fshatin Xiber Murrize		0	60	73	82%
Mbikq.Ndertim mure mbajtes		0	50	63	79%
Mbikq.rikual.pjesshem urban i qytetit		0	0	75	0%
Mbikq.sistem.asfaltim ne lagjet e qytetit		0	0	78	0%
Nd.dhe riparime rrugesh ne Bashkine Klos		276			
Nd.Ura te Liçi		0	583	583	100%
Ndertim akse rruge ne fshatra		0	2,210	2,210	100%
Ndertim kamba ure ne Fshatin Xiber Murrize		1,958	836	836	100%
Ndertim mure mbajtes		0	2,304	2,304	100%
Ndertim muresh ne rruget e Bashkise	1,295	2,449			
Rik ne rruget e Njesise Ad.Gurre	0	0	2,828	2,828	100%

Rik.rruge kal. Pet,rruga G. Vogel,nd.ure Lela-Arriku	2,149	3,389	2,000	2,000	100%
Rikonst.rruga Dars		0	3,885	3,885	100%
Riparim urash		443			
Shërb.projektimi për projektin "Ndërtim këmba ure", Ura e Domit			498	500	100%
Shërb.projektimi sistemim-asfaltim rruga Guri i Bardhë - Shkallë			0	500	0%
Sherbime projektimi per projekte financ.nga Bashkia		3,600			

Strehimi Social




Figura 10: Kategoritë e shpenzimeve për programin Strehimi Social: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia harton dhe zbaton politika dhe ndërhyrje konkrete për mbështetjen e familjeve në nevojë me strehim social.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kosto e bashkisë për programin e strehimit social kundrejt numrit total të përfituesve nga (Mijë Lekë / përfitues)	24.8	97.3	8.8	
Numri personave të mbështetur me strehim social sipas kategorive (Ndryshimi vjetor në %)	17	16	96	-137

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Persona të mbështetur me strehim social	25	41	137	0

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fonde të alokuara si mbështetje e bashkisë për strehim social Në mijë lekë	619	3,989	1,206	0

Performanca e shërbimit

Bashkia ka shpenzuar fonde për mbështetjen e familjeve të cilat plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar strehim social në masën 100% të planit 2021. Bashkia alokon rreth 2% të buxhetit të saj për këto shërbime. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është shtuar numri i familjeve përfituese me strehim social. Gjatë vitit 2021 përfituan gjithsej 137 familje nga 41 që u mbështetën në vitin 2020 duke trefishuar mbështetjen e saj në këtë drejtim
- ✿ Edhe pse kanë rënë fondet e alokuara për këtë shërbim bashkia ka mundur të gjendet pranë familjeve nevojtare qoftë edhe me ndërhyrje të vogla në banesat e tyre ekzistuese.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Strehimi Social	619	3,989			
Ne mijë Leke					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Adoptimi dhe Rik. I godines se ish komunes		0	2,635	2,635	100%
Kontr.Ndertim banesa per te varfrit		3,959			
Mbikq.Adoptimi dhe Rik. i godines se ish komunes			45	57	
Mbikqyrje Ndertim banesa per te varfrit		30			